

# KËSHILLA PËR NISJEN E SHKOLLËS



Bild: Julia Ferrer Vilchez

**ALBANISCH**



Përgjegjës për përmbajtjen:

Falënderojmë KI Bielefeld për lejen e përdorimit të përmbajtjes së kësaj broshure, e cila u përpunua në bashkëpunim me KI Bielefeld dhe Zyrën për të Rinjtë dhe Familjen e qytetit Bielefeld.

Për pjesën e Wuppertal-it:

Heike Waltenberg, Alexandra Hillenbrand nga KI Wuppertal

Versioni dixhital (pdf) në:

<https://integration.wuppertal.de/familie-und-kinder/familie-bildung-und-erziehung/integration-und-bildung.php>



Stadi 01/2026

KI Wuppertal mbështetet nga:

Ministerium für Kinder, Jugend, Familie,  
Gleichstellung, Flucht und Integration  
des Landes Nordrhein-Westfalen



Ministerium für  
Schule und Bildung  
des Landes Nordrhein-Westfalen



## Përmbajtja

|  |    |
|--|----|
| 1. PARATHËNIE                                  | 4  |
| 2. TË JESH NË LËVIZJE – BAZA PËR TË MËSUARIT   | 6  |
| 3. TRAJNIMI I DUARVE                           | 8  |
| 4. BËRJA I PAVARUR                             | 10 |
| 5. SHOQËRIMI ME FËMIJËT E TJERË                | 12 |
| 6. TË USHQEHIMI DHE TË PIMË SHËNDETSHËM        | 14 |
| 7. LEXONI, TREGONI HISTORI DHE LUANI ME GJUHËN | 16 |
| 8. FLISNI DISA GJUHË                           | 18 |
| 9. BËNI MUZIKË, LUANI ME TONE                  | 20 |
| 10. ZBULONI MATEMATIKËN NË JETËN E PËRDITSHME  | 22 |
| 11. EKSPERIMENTONI DHE HABITUNI                | 24 |
| 12. EKSPLORONI DHE MBRONI NATYRËN              | 26 |
| 13. SI TË SILLENI ME MEDIAT                    | 28 |
| 14. KONTROLLI MJEKËSOR I HYRJES NË SHKOLLË     | 31 |
| 15. KENI NEVOJË PËR MBËSHTETJE?                | 32 |
| TË DREJTAT E AUTORIT                           | 34 |

## 1. PARATHËNIE

Të dashur prindër dhe kujdestarë ligjorë,

Së shpejti, fëmija juaj shkon në shkollë dhe fillon një kohë e veçantë. Ju si prindër mund të kontribuoni shumë që fëmija juaj të jetë i përgatitur mirë për fillimin e shkollës.

Për këtë gjeni ide dhe sugjerime në këtë broshurë, të cilat mund t'i zbatoni thjeshtë dhe pa shumë mundim. Sugjerimet ju ofrojnë shumë mundësi për ta mbështetur fëmijën tuaj në rutinën e përditshme, të cilat ndoshta nuk do t'ju kishin rënë ndër mend që përvoja të tilla janë të rëndësishme për fillimin e shkollës.

Cilat ide dëshironi t'i provoni me fëmijën tuaj?

Ju uroj juve dhe fëmijës suaj shumë qejf, një kohë emocionuese deri në hyrjen në shkollë dhe një kohë të mirë shkollore.



Arlin Çakal-Rasch

Drejtores e Qendrës Komunale të Integritimit



## 2. TË JESH NË LËVIZJE – BAZA PËR TË MËSUARIT

Lëvizja ju ndihmon gjatë të mësuarit. Nëse fëmija juaj lëviz shumë dhe me kënaqësi, ai mund të mësojë më mirë. Pas kësaj, edhe lëvizjet e vogla gjatë shkrimit kryhen më mirë. Në jetën e përditshme ka shumë mundësi për lëvizje.

### Ide:

- Dilni me fëmijën tuaj jashtë: në një park, në pyll ose në këndin e lojërave. Atje, ai mund të vrapojë, të kacavaret, të luaj top dhe shumë gjëra të tjera. Gjetja e hapësirave të blerta dhe këndeve të lojës bëhet shumë lehtë nëpërmjet aplikacionit Tal.App të WSW-së.

[https://www.wuppertal.de/microsite/jugend\\_freizeit/spielplaetze/index.php](https://www.wuppertal.de/microsite/jugend_freizeit/spielplaetze/index.php)



- Në banesë fëmija juaj mund të luaj me jastëkë, dyshekë dhe gjëra të tjera. Mbi to ai mund të bëjë mjaft mirë gjimnastikë dhe të kërcejë.
- Fëmija juaj duhet të luajë sa më shpesh të jetë e mundur me fëmijët e tjerë.

- Lëvizja me biçikletë ose skuter të jep kënaqësi. Në këtë mënyrë fëmija juaj ushtrohet, për shembull, të mbajë ekuilibrin.



- Shkoni me fëmijën tuaj në pishinë. Është mirë kur fëmija juaj përjeton kënaqësi në ujë. Në një kurs noti fëmija juaj mund të mësojë të notojë.

[www.wuppertal.de/tourismus-freizeit/baeder/](http://www.wuppertal.de/tourismus-freizeit/baeder/)

- Ju jeni shembulli më i rëndësishëm për fëmijën tuaj. Prandaj: Lëvizni vetë shumë!

Kini besim te aftësitë e fëmijës suaj! Nëpërmjet lëvizjes fëmija juaj mëson çfarë mund të bëjë dhe çfarë duhet të ushtrojë.



### 3. TRAJNIMI I DUARVE

Për të shkruar dhe për punë dore në shkollë, fëmija juaj ka nevojë për duar të shkathëta. Shkathësinë mund ta nxitni gjatë përditshmërisë dhe kur luani.

#### Ide:

##### Në kuzhinë

- Gatvani së bashku me fëmijën tuaj. Fëmija juaj mund të presë perime, të brumosë brumin dhe të lajë enët. Kjo jep kënaqësi dhe përmirëson shkathësinë.

##### Punë dore

- Organizoni me fëmijën tuaj një vend të caktuar për punë dore. Atje fëmija juaj, për shembull, mund të ngjyrosë, të brumosë dhe të presë letra. Ai mund të krijojë gjëra edhe me dru dhe gjethe nga pylli.



### Loja

- Shumë lojëra nxisin shkathësinë e gishtave. Për shembull: Puzzle, Mikado, blloqe druri, perla, rruga e goglave, Lego®



Tregoni kujdes që, kur vizaton, fëmija juaj ta mbajë mirë lapsin, pavarësisht se me cilën dorë.



## 4. BËRJA I PAVARUR

A mund të bëjë fëmija juaj shumë gjëra vetëm? Atëherë, fëmija juaj do të ndjehet më i sigurt në shkollë. Fëmijët e pavarur kanë më shumë dëshirë për të mësuar dhe janë më të vetëdijshëm.

Prandaj, pyetni veten herë pas here: Çfarë mund të bëjë fëmija im vetëm? Me çfarë duhet ta ndihmoj?

### Ide:

- Ushtroni me fëmijën tuaj veshjen dhe zhveshjen. Për shembull këpucët, xhupat dhe veshjet sportive.
- Mendoni së bashku me fëmijën tuaj: Cilat punë dëshiron fëmija juaj të bëjë në shtëpi? Për shembull ai mund të shtrojë tavolinën. A e ka përmbushur fëmija juaj punën e tij? Atëherë, lavdërojeni.



- Fëmija juaj duhet të shkojë vetë në banjë. Ai duhet t'i lajë vetë duart.

- Në fillim paketojeni çantën e shkollës së bashku me fëmijën tuaj. Me kalimin e kohës, fëmija juaj mund ta paketojë vetëm çantën.
- Tregojani që herët rrugën për në shkollë fëmijës suaj. Shikoni gjithashtu së bashku ambientin përreth.



Nisja e shkollës do të thotë për të gjithë familjen ndryshime të mëdha. Ndoshta fëmija juaj është i pasigurt në javët e para. Atëherë kini durim.

Thoni atij shpesh: "TI DO T'IA DALËSH!"

## 5. SHOQËRIMI ME FËMIJËT E TJERË

Për nisjen e shkollës është gjë e mirë nëse fëmija juaj shoqërohet me fëmijët e tjerë. Ata luajnë, hanë dhe vizatojnë. Ata grinden dhe e durojnë njëri-tjetrin. Ata bëhen të zhurmshëm dhe qetësohen.

### Ide:

- Dërgojeni fëmijën tuaj rregullisht në qendrën ditore.
- Ftoni shokë dhe shoqe të fëmijës suaj për të luajtur. Fëmija juaj duhet të vizitojë edhe fëmijë të tjerë.
- Tregojuni fëmijëve lojëra sociale. Kështu fëmija juaj mëson të fitojë dhe të humbë. Mëson gjithashtu si t'u përmbahet rregullave.



- Sporti, vallëzimi dhe muzika në grup krijojnë kënaqësi të veçantë. Shoqatat dhe shkollat e muzikës kanë shumë oferta për fëmijë:

[https://www.wuppertal.de/microsite/jugend\\_freizeit/jugendsport/index.php](https://www.wuppertal.de/microsite/jugend_freizeit/jugendsport/index.php)

[https://www.wuppertal.de/microsite/jugend\\_freizeit/jugendbildung/](https://www.wuppertal.de/microsite/jugend_freizeit/jugendbildung/)

- Merrni pjesë në evenimente për familje. Stacioni i natyrës dhe mjedisit ka oferta për fëmijë dhe familje:

[www.stnu.de](http://www.stnu.de)



## 6. TË USHQEHEMI DHE TË PIMË SHËNDETSHËM

Ushqimi dhe pirja e shëndetshme janë të rëndësishme.

Në këtë mënyrë fëmija juaj mund të rritet dhe mësojë mirë. Disa ushqime duhet t'i hajë shpesh fëmija juaj. Ushqime të tjera fëmija juaj duhet t'i hajë rrallë. Qendra Federale për sqarimin shëndetësor jep sugjerime:

### **Këto duhet t'i hanë dhe pinë shpesh fëmijët:**

- Fruta, perime, patate, makarona, oriz dhe bukë
- Ujë, çaj pa sheqer

### **Këto duhet t'i hanë me kufizim fëmijët:**

- Qumësht, djathë, mish, sallam, vezë, peshk

### **Këto duhet t'i hanë pak fëmijët:**

- Gjalpë, vaj, ajkë qumështi, ëmbëlsira, rosticeri të kripura

### **Këto duhet t'i hanë dhe pinë vetëm rrallë fëmijët:**

- Fast Food (patatet e skuqura, hamburgerët, picat, ...)
- pije të ëmbla (limonat, lëngje frutash, ...)



## Ide:

- Merrni kohë për të ngrënë me fëmijën tuaj. Kjo kohë e përbashkët është e rëndësishme për familjen. Këtu fëmija juaj mëson shumë: Si duhet ta mbaj siç duhet thikën dhe pirunin? Si duhet të filloj të ha? Kur më lejohet të ngrihem?
- Planifikoni së bashku çfarë dëshironi të hani. Për shembull, ju mund të sugjeroni dy specialitete. Pastaj, fëmija mund të zgjedhë njërin prej tyre.
- Përgatitni ushqimin së bashku me fëmijën tuaj. Në këtë mënyrë mësohet shumë mbi artikujt ushqimorë. Përveç kësaj, gjatë prerjes fëmija juaj ushtrohet si të veprojë më me shkathtësi me duart e tij.
- Lëreni fëmijën tuaj të vendosë vetë se sa dëshiron të hajë. Fëmijët mund ta vlerësojnë mirë se kur janë të ngopur. Besojini ndjesisë së fëmijës suaj.
- Fëmijët mendojnë pozitivisht mbi ushqimin dhe pijet. Atyre u pëlqen të provojnë. Ofrojini fëmijës suaj ushqime të ndryshme.
- Produktet për fëmijët shpesh janë jo të shëndetshme. Vini re të dhënat për sheqerin dhe yndyrën në paketim.
- Bëhuni shembull për fëmijën tuaj gjatë blerjes dhe ngrënies.



## 7. LEXONI, TREGONI HISTORI DHE LUANI ME GJUHËN

Leximi është i rëndësishëm! Fëmija juaj mëson fjalë dhe fjali të reja. Kjo ndihmon mësimin e leximit dhe shkrimit. Nëpërmjet librave dhe historive fëmija juaj mëson shumë për botën. Prandaj, leximi dhe tregimi i historive duhet të jenë pjesë e së përditshmes të çdo familjeje.

### Ide:

- Shikoni së bashku me fëmijën tuaj libra me figura. Flisni me të rreth figurave. Pyeteni për shembull: Çfarë sheh në figurë?
- Kërkoni fjalët që rimojnë. Për shembull shtëpi – mi.
- Pyetni fëmijën tuaj cilin libër dëshiron që t'ia lexoni.
- Lexoni me entuziazëm. Ndryshoni zërin: Ariu mund të lexojë me zë të thellë dhe të murmurijë. Miu mund të pëshpëritë. Gjarpri fishkëllon.
- Lexoni gjithmonë në një kohë të caktuar. Për shembull, para rënies në gjumë. Kënaquni me afërsinë me fëmijën tuaj.



### Prindërit që lexojnë janë shembuj për fëmijët e tyre!

- Vizitoni së bashku me fëmijën tuaj bibliotekën.
- Luani me gjuhën gjatë udhëtimeve të gjatë në makinë ose në tren. Për shembull, fëmija juaj mund të grumbullojë fjalë: Cilat kafshë jetojnë në ujë? Cilat kafshë jetojnë në ajër?
- Përshkruani një kafshë dhe fëmija juaj duhet ta gjejë. Për shembull: Unë njoh një kafshë që ka një feçkë të gjatë. Fëmija juaj gjithashtu mund të përshkruajë kafshë dhe t'i gjejë.
- Tregoni fillimin e një historie. Lëreni fëmijën tuaj ta gjejë se cila histori është. Ose lëreni fëmijën të tregojë më tej.
- Luani me fëmijën tuaj: "Unë shoh diçka që ti nuk e sheh dhe është blu. Çfarë është?" Fëmija juaj kërkon objektin.
- Tregojini fëmijës suaj jashtë shkronjat, shkrimin dhe simbolet. Fëmija juaj mund të zbulojë taraga makinash, tabela, logo ose emra.

## 8. FLISNI DISA GJUHË

Shumë fëmijë në Gjermani rriten me disa gjuhë. Këto gjuhë të ndryshme janë një fitim i madh për shoqërinë tonë.

A flisni në shtëpi (shpesh) një gjuhë tjetër përveç gjermanishtes?

Atëherë, nxiteni fëmijën tuaj në gjuhën e familjes suaj! Sepse:

Fëmija juaj mund të mësojë gjuhën e familjes dhe gjermanisht.

E rëndësishme është që fëmija juaj të flasë të dyja gjuhët në përditshmëri.

### Ide:

- Ju jeni shembulli më i rëndësishëm për fëmijën tuaj. Edhe për gjuhën. Flisni shumë me fëmijën tuaj. Sa më shumë fjalë që të përdorë fëmija juaj, aq më mirë mund ta kuptojë botën.
- Mbështetni interesin e fëmijës suaj në gjuhën e familjes: Tregojini fëmijës suaj histori, flisni me rimë. Këndoni së bashku këngë nga fëmijëria juaj.
- Libra dhe lojëra akustike në gjuhën tuaj mund t'i huazoni falas në librari:

<https://www.wuppertal.de/microsite/stadtbibliothek/bildungsangebote/kinder-und-jugendliche.php>

Kur regjistrohemi në shkollë, pyesni nëse ka mësim gjuhe në gjuhën e familjes suaj (mësim i gjuhës së origjinës)



Konsulencë lidhur me mësimin e gjuhës së origjinë gjeni këtu:

Qyteti Wuppertal – Qendra komunale e integritimit

[hsu@stadt.wuppertal.de](mailto:hsu@stadt.wuppertal.de)

Telefon: 0202 563-2098

## 9. BËNI MUZIKË, LUANI ME TONE

Fëmijëve u pëlqen shumë muzika. Ata vallëzojnë sapo të dëgjojnë muzikë. Ata provojnë çdo gjë që bën zhurmë ose tone. Muzika e ndihmon fëmijën tuaj gjatë zhvillimit të tij. Kush këndon mëson më lehtë të flasë. Kush vallëzon mund të lëvizë më mirë. Së bashku me fëmijët e tjerë muzika krijon më shumë kënaqësi.

### Ide:

- Këndoni me fëmijën tuaj. Ushtroni me të rima fëmijësh.
- A festoni festa? Këndoni edhe këngë tradicionale.
- Tenxheret, gotat dhe pllakat e tryezës tingëllojnë mrekullueshëm!

Lëreni fëmijën të provojë tone. Edhe nëse për ju ndonjëherë është e vështirë.



- Ndërtoni me fëmijën tuaj instrumentet tuaja. Mbushni kanoçe ose gota të vjetra për shembull me pulla ose oriz.
- Vini re së bashku me fëmijën tuaj tonet e jetës së përditshme. Çfarë dëgjoni në natyrë? Çfarë ka në rrugë? Çfarë ka në shtëpi?
- Dëgjoni me fëmijën tuaj muzë të ndryshme. Për shembull, këngë për fëmijë, muzikë pop ose muzikë klasike.



- Shkollat e muzikës dhe të vallëzimit ofrojnë kurse për fëmijët. Edhe në shoqatat sportive ka kurse vallëzimi.

Për shembull këtu: <https://www.wuppertal.de/bergische-musikschule>

## 10. ZBULONI MATEMATIKËN NË JETËN E PËRDITSHME

Matematika është kudo. Në jetën e përditshme gjeni numra, forma dhe dimensione. Ju mund ta kënaqni fëmijën tuaj me lojëra për këto.

### Ide:

- Numëroni së bashku me fëmijën tuaj. Për shembull: Frutat në pjatë, flluskat në gotë ose shishet në një arkë.
- Kërkoni më fëmijën tuaj numra. Për shembull: Numra të shtëpive, targat e makinave ose etiketat e çmimeve.
- Luani lojëra letrash me numra, domino dhe lojëra me zar.
- Bëjeni fëmijën tuaj të ndërgjegjshëm për orën. Tregojini atij akrepin e madh dhe të vogël dhe shifrat.
- Thoni fëmijës suaj sa është ora. Për shembull, kur shkoni në qendrën ditore ose kur fëmija juaj shkon të flejë.
- Flisni me fëmijën tuaj rreth ditëve të javës. Tregojini fëmijës tuaj se çfarë planifikoni të bëni në ditën e caktuar të javës.



- Përfshijeni fëmijën tuaj në kuzhinë. Lëroni të masë ose të peshojë miel ose sheqer me gotën matëse.



- Nxiteni fëmijën tuaj të krahasojë gjëra. Për shembull:  
Gjej shkopin më të gjatë.  
Gjej shtëpinë më të lartë.  
Gjej domaten më të vogël.
- Lëroni fëmijën tuaj të kërkojë objekte sipas madhësisë, ngjyrave dhe formave. Çfarë është e rrumbullakët?  
Çfarë ka tre kënde?  
Çfarë ka katër kënde?
- Luani me fëmijën tuaj në arkë me rërë. Lëroni fëmijën tuaj të mbushë rërë ose ujë në kova të mëdha të ndryshme



## 11. EKSPERIMENTONI DHE HABITUNI

Fëmijët janë kuriozë. Ata dëshirojnë të zbulojnë dhe kuptojnë botën. Për këtë ju mund ta ndihmoni fëmijën tuaj. Shkenca natyrore nga takon në shtëpi dhe jashtë.

### Ide:

#### Në shtëpi

- Piqni së bashku një tortë. Merrni një recetë me brumë majaje. Para pjekjes, tregojani fëmijës tuaj majanë. Vëzhgoni së bashku çfarë ndodh me majanë në brumë.
- Mbushni ujë në një enë të madhe prej xhami. Lëreni fëmijën tuaj të vendosë gjëra të ndryshme në ujë. Për shembull monedha, gurë, gogla druri ose kube akulli. Vëzhgoni me fëmijën tuaj: Çfarë noton mbi ujë? Çfarë bie poshtë?
- Ndërtoni një kështjellë me copa druri ose kuti. Lëreni fëmijën ta provojë: Si mund të ndërtoj një kullë të lartë që ajo të mos rrëzohet?



- Ushtroni me fëmijën tuaj se si të përdorë pajisje teknike. Për shembull fshesën me korrent ose impiantin e muzikës.
- A është e prishur fshesa me korrent? Atëherë kërkoni shkakun së bashku me fëmijën tuaj. A është plot qesja e mbeturinave? A është bllokuar tubi?

### Jashtë

- Ndërtoni me fëmijën tuaj një dragua. Lëreni së bashku që ai të ngrihet. Vëreni: Si duhet të lëvizë dragoi në mënyrë që të fluturojë? Çfarë roli luan era?
- A ka një përrua afër jush? Ndërtoni me fëmijën tuaj një digë. Lëreni atë të vëzhgojë se çfarë ndodh. Me çfarë ndërtohet mirë një digë? A rrjedh ende ujë përmes digës? Pse?

Në biblioteka ju mund të gjeni shumë libra, lojëra akustike dhe filma rreth temës së eksperimenteve në jetën e përditshme.

Ka gjithashtu edhe programe të përshtatshme televizive. Për shembull: Programi me miun, luleradhiqen, njohuria bën Ah!, Checker Tobi.



Për këtë, universiteti Junior ofron kurse.

[www.junioruni-wuppertal.de](http://www.junioruni-wuppertal.de)

Pse nuk mund të kolovitesh vetëm?

## 12. EKSPLORONI DHE MBRONI NATYRËN

Bëni së bashku me fëmijën tuaj ekskursionë në park ose në pyll. Kështu fëmija juaj mund të njohë natyrën.

Ekskursionet e ndihmojnë fëmijën tuaj të sillet me respekt ndaj kafshëve dhe mjedisit. Në këtë mënyrë, fëmija juaj mëson gjithnjë e më tepër si të respektojë mjedisin.

### Ide:

- Në natyrë ju mund të zbuloni shumë. Bëni një shëtitje me fëmijën tuaj. Tregojini atij pemë, lule dhe kafshë.
- Flisni me fëmijën tuaj rreth stinëve. Si ndryshon natyra në pranverë ose vjeshtë?
- Kërkoni me fëmijën tuaj një pemë. Shikojeni pemën pas çdo dy javësh: Çfarë ndryshon? Çfarë ndodh me gjethet? A varen fruta në pemë? Si ndihet lëvozhga?
- Mundësoni fëmijën tuaj që të marrë përgjegjësi. Ai mund të kujdeset në shtëpi për një bimë.
- Dalloni me fëmijën tuaj bimë të ngrënshme dhe të pangrënshme. Mbillni për shembull groshël. Vëzhgoni me fëmijën tuaj se si rritet groshëla. Më vonë mund ta vilni groshëlen. Ajo shijon për shembull në supë ose mbi bukë.

- Gjatë një ekskursioni në parkun e kafshëve, fëmija juaj mund të njohë, të ushqejë dhe të lehtëtojë kafshë të ndryshme.



<http://www.jugendfarm-wuppertal.de>


- Tregoni fëmijës tuaj nga vjen qumështi dhe vezët. Vizitoni së bashku një fermë ose një livadh lopësh.
- Ushtroni së bashku me fëmijën tuaj një sjellje plot respekt me natyrën. Tregoni atij si mund të evitohet mbeturinat. Merrni me vete për shembull një çantë për blerje.
- Shpjegoni atij se mbeturinat nuk hidhen në natyrë. Mbeturinat hidhen në bidonin e mbeturinave.
- Mbrojtjen e mjedisit mund ta ushtroni edhe në shtëpi. Për shembull: Diskutoni me fëmijën tuaj: Cilat mbeturina hidhen në bidonin përkatës? Shpjegoni atij se nuk ka pafund ujë. Mbylleni rubinetin e ujit kur lani dhëmbët.

### 13. SI TË SILLENI ME MEDIAT

Sot, fëmijët rriten me shumë media. Për shembull kompjuter, smartfon dhe tablet. Atyre u pëlqen shumë se çfarë mund të bëjnë me to. Shoqërojeni fëmijën tuaj kur ai i përdor ato. Televizionet dhe smartfonet duhet të alternohen me lojëra të tjera dhe lëvizja.

#### Ide:

- Në moshën parashkollore fëmijët shohin me kënaqësi filma të shkurtër në televizion. Kërkoni me fëmijën tuaj një film shkurtër. Për këtë mund të përdorni për shembull [www.flimmo.de](http://www.flimmo.de). Vini re se për cilën moshë është i lejuar filmi. Kjo qëndron shpesh në shkurtimin "FSK".
- Shikoni së bashku me fëmijën tuaj filma. Flisni me të rreth përmbajtjes. A dëshiron fëmija juaj të vizatojë një figurë lidhur me filmin? Në këtë mënyrë ai mund ta përpunojë përmbajtjen.
- Përcaktoni se sa shpesh mund t'i përdorë mediat fëmija juaj. Kohën mund ta cilësoni së bashku në një kohëmatëse për zierjen e vezëve. Fëmija juaj nuk duhet të shohë televizor më shumë se 30 minuta në ditë.
- Lojëra akustike, libra audio dhe këngë për fëmijë mund t'i dëgjojë vetëm fëmija juaj. Por ju duhet të jeni afër. Ju duhet të dini se çfarë dëgjon aktualisht fëmija juaj. Ju mund të huazoni lojëra akustike në bibliotekë.
- A ka fëmija juaj një pyetje? Atëherë kërkoni së bashku një përgjigje. Këtu mund të ndihmojë edhe një makineri kërkimi si për shembull [www.fragfinn.de](http://www.fragfinn.de).



- Në një konsol ose në smartfon fëmija juaj mund të luajë lojëra. Për këtë fikni internetin nga pajisja. Vini re që loja të jetë lejuar për grupmoshën e fëmijës suaj. Qëndroni pranë fëmijës suaj. Përfundojeni lojën nëse fëmija juaj bëhet i nervozuar.
- Lëroni fëmijën tuaj të fotografojë dh filmojë vetë. Më vonë fëmija juaj mund të tregojë çfarë ka përjetuar rreth fotove. Në këtë mënyrë kujtimet mbeten gjallë.

Këto këshilla mund t'i lexoni më në detajë në internet:

[www.schau-hin.info](http://www.schau-hin.info)



### Udhëzime të tjera për shembull në:

<https://wir-machen-kinderseiten.de/wiki/klick-tippsnet-empfehlungsdienst-fuer-gute-kinderseiten-und-kinder-apps>

[www.klicksafe.de](http://www.klicksafe.de)

### Makeri kërkimi për fëmijë:

[www.blinde-kuh.de](http://www.blinde-kuh.de)

[www.fragfinn.de](http://www.fragfinn.de)

### Rreth temës së televizionit:

[www.kinderfilmwelt.de](http://www.kinderfilmwelt.de)

[www.flimmo.de](http://www.flimmo.de)

[www.tivi.de](http://www.tivi.de)

[www.checkeins.de](http://www.checkeins.de)

[www.kika.de](http://www.kika.de)



## 14. KONTROLLI MJEKËSOR I HYRJES NË SHKOLLË



Para se fëmija juaj të fillojë shkollën bëhet kontrolli mjekësor i hyrjes në shkollë. Ai është i detyruar sipas ligjit dhe është i detyrueshëm për çdo fëmijë. Kontrolli kryhet nga mjekë të zyrës së shëndetësisë. Ftesën për kontrollin mjekësor të hyrjes në shkollë e merrni

automatikisht me postë. Ajo vjen nga gushti ose më së voni deri në pushimet verore të vitit kur fëmija juaj fillon shkollën. Gjatë kontrollit mjekësor shihet se si po ecën dhe si po zhvillohet fëmija juaj: a është ai gati për shkollë? Përveç kësaj, kontrollohet nëse fëmija juaj ka nevojë për mbështetje të veçantë për ta nisur mirë shkollën.

### Zyra e Shëndetësisë Wuppertal

Shërbimi shëndetësor për fëmijët dhe të rinjtë (305.3)

Willy-Brandt-Platz 19

42105 Wuppertal



Website:  
Einschulungsuntersuchung

### Kontakti me telefon

E hënë - E enjte ora 08:00 - 15:00

E premte nga ora 08:00 - 13:00

Telefoni 0202 563-8008

Email [einschulungsuntersuchung@stadt.wuppertal.de](mailto:einschulungsuntersuchung@stadt.wuppertal.de)



## 15. KENI NEVOJË PËR MBËSHTETJE?

këtu gjeni ndihmë nëse ju ose fëmija juaj keni nevoja të veçanta ose pyetje:

### **Konsulencë shkollore për familjet që kanë emigruar së fundi**

Stadt Wuppertal – Kommunales Integrationszentrum

Friedrich-Engels-Allee 28, 42103 Wuppertal

Telefon: 0202 563 4555

[schule.intergration.204@stadt.wuppertal.de](mailto:schule.intergration.204@stadt.wuppertal.de)

### **Schulpsychologische Beratung (208.32)**

Friedrich-Ebert-Str. 27, 42103 Wuppertal

Telefon: 0202 563 6990

[schulpsychologische.beratung@stadt.wuppertal.de](mailto:schulpsychologische.beratung@stadt.wuppertal.de)

### **Schulamt für die Stadt Wuppertal - Inklusionsbüro**

Alexander Str. 18, 42103 Wuppertal

Telefon: 0202 563 2401

[206-inklusionsbuero@stadt.wuppertal.de](mailto:206-inklusionsbuero@stadt.wuppertal.de)

### **Shkollat filllore në Wuppertal**

<https://www.wuppertal.de/kultur-bildung/schule/anmeldungen/schulen-anmeldetermine.php>



### **Cura gGmbH Interdisziplinäre Frühförder- und Beratungsstelle**

Friedrich-Engels-Allee 430-432

42283 Wuppertal

Tel: 0202 265 465-0

Faks: 0202 265 465-19

<https://cura-wuppertal.de/>

### **Autismus-Ambulanz und Beratungsstelle**

Wuppertal gGmbH,

Friedrich-Engels-Allee 432

42283 Wuppertal

Tel: 0202 74 79 58-30

Faks: 0202 74 7958-21

[info@autismusambulanz.de](mailto:info@autismusambulanz.de)

### **Familienberatung Wuppertal**

Beratung für Kinder, Jugendliche und Eltern

Friedrich-Ebert-Str. 27

42103 Wuppertal

Tel: 0202 563 6644

[Beratung.fuer.kinder.jugendliche.eltern@stadt.wuppertal.de](mailto:Beratung.fuer.kinder.jugendliche.eltern@stadt.wuppertal.de)

<https://www.wuppertal.de/vv/oe/208.31.php>

### **Wuppertaler Kindertafel**

<https://www.tafel-wuppertal.de/hilfe-erhalten/kindertafel>

### **Kinderschutzbund Wuppertal**

<https://kinderschutzbund-wuppertal.de/aktuelles/>

### **KinderTal**

<https://www.kindertal.de/>



## TË DREJTAT E AUTORIT

### Fleta e titullit:

Faqja e parë: Julia Ferrer-Vilchez

Faqja e fundit: pixabay license

### Përmbajtja:

Faqja 5: pixabay licence

Faqja 6: © PantherMedia / Monkeybusiness Images

© PantherMedia / Monkeybusiness Images

Faqja 7: © PantherMedia / anatols

Faqja 8: pixabay license

Faqja 9: © PantherMedia / EdZbarzhyvetsky

pixabay license

Faqja 10: © PantherMedia / StephanieFrey

© PantherMedia / JCB Prod

Faqja 11: © PantherMedia / luninastock

Faqja 12: © PantherMedia / gpointstudio

Faqja 13: © PantherMedia / natochka

Faqja 14: © PantherMedia / Monkeybusiness Images

Faqja 15: © PantherMedia / creatista

Faqja 16: © PantherMedia / Arne Trautmann

Faqja 17: © PantherMedia / londondeposit

Faqja 19: © privat Heike Waltenberg

Faqja 20: © PantherMedia / Dmyrto\_Z

Faqja 21: © PantherMedia / Craig Robinson

Faqja 22: © PantherMedia / Katy Spichal

Faqja 23: © PantherMedia / Wolfgang Steiner

© PantherMedia / choreograph

Faqja 24: © PantherMedia / natochka

© PantherMedia / pathastings

Faqja 25: © PantherMedia / BestPhotoStudio

Faqja 27: © PantherMedia / Xalanx

Faqja 29: © PantherMedia / Wong Sze Fei

Faqja 30: © PantherMedia / Xalanx

Faqja 31: © stock.adobe.com / pressmaster



